

Shpallje për Punë

UDHËHEQËS TEKNIK/MENAXHER I NDËRMARRJES KOMUNALE

Punëdhënësi: NPK Moravica, Preshevë

Vendi: Preshevë

Ndërmarrja Publike Komunale Moravica shpallë konkurs për të punësuar një **Udhëheqës Teknik/Menaxher i Ndërmarrjes Komunale**. Udhëheqësi është i/e detyruar që në bashkëpunim të ngushtë me shërbimet e NPKsë dhe në marrëveshje me drejtorin e NPKsë punon në menaxhimin dhe përmirësimin e punës dhe funksionimit të përgjithshëm të Ndërmarrjes Publike Moravica në Preshevë.

Përshkrimi i punës:

- Monitorimi dhe përmirësimi i punës së sektorëve të NPKsë: sektori i ujësjellësit dhe kanalizimit, sektori i shërbimeve komunale dhe sektori i shërbimeve të përbashkëta;
- Krijimi i qëllimeve strategjike duke grumbulluar informata relevante;
- Monitorimi i rregulloreve ligjore dhe përgjegjësia për zbatimin e tyre;
- Përshtatja e strategjisë së ndërmarrjes me qëllim të zhvillimit të mëtejshëm;
- Përmirësimi i atyre ekzistuese si dhe krijimi i standardeve dhe procedurave të reja operative;
- Përgatitja e përlogaritjes së projektit dhe arsyesimit të aktivitetit;
- Zbatimi i planit të aktiviteteve dhe arritja e qëllimeve të paracaktuara;
- Menaxhimi i burimeve njerëzore me synim realizimin efektiv dhe efikas të qëllimeve;
- Menaxhimi i aktiviteteve ditore, motivimi dhe zhvillimi i ekipit;
- Koordinimi i kryerjes së detyrës si dhe korigjimi i parregullsive gjatë ekzekutimit;
- Kontrolli i rezultateve të punës dhe zbatimit të planit të aktiviteteve;
- Mbledhja e reagimeve të klientëve dhe hulumtimi i tregut;
- Të punohet në përmirësimin e marrëdhënieve me publikun;
- Përgatitja dhe dorëzimi i raporteve mbi aktivitetet, si dhe ofrimi i ndihmës teknike dhe profesionale për të punësuarit;
- Me urdhër të drejtorit, kryen edhe detyra të tjera për menaxhimin dhe përmirësimin e punës së përgjithshme të NPKsë

Kushtet:

- Të ketë të përfunduar shkallën e VII të kualifikimit profesional;
- Njohuri të shkëlqyeshme komunikative dhe të shkruarit në gjuhën serbe, njohja e gjuhës angleze është përparësi;
- Të jetë i organizuar, i vendosur, kompetent dhe kreativ;
- Patent shoferi të kategorisë B;
- Përvojë pune minimum 3 vite në pozita udhëheqësi ose menaxheri;
- E preferuar përvoja në udhëheqjen e kompanive, sipërmarrjeve, etj.;
- Njohja e punës në kompjuter (MS office, internet explorer, etj.).

Kandidatët e interesuar mund të aplikojnë përmes CVsë duke bashkangjitur të dhënat tjera për të përmbushur kushtet e shpalljes (fotokopja e diplomës, fotokopja e leternjoftimit) përmes postës elektronike jp.np.moravica@hotmail.com ose personalisht tek zyret e NPK Moravica, rruga Q. Shehu pn, Preshevë.

Vetëm kandidatët të cilët përmbushin kushtet e paraqitura dhe hyjnë në rrethin e ngushtë do të kontaktohen .

Afati i konkurimit: 15 Gusht 2018